



**NGRITJA
E ZËRIT**

Tel: 044 195-113
044 633-325
Adresa: Rruga e UÇK-së,
Skenderaj
Email: info@ngritjaezerit.org
Web: www.ngritjaezerit.org

GJYKATES KOMUNALE NE SKENDERAJ

PADITES: Fazli Barani nga f.sh. Klinikë e Epërme, 41000 Skenderaj,
Republika e Kosovës

E PADITUR: REPUBLIKA E SERBISË – Qeveria e R.S. rr. e Nemanjës
nr.11 11000 Beograd

PADI PER KOMPENZIM DEMI

Propozim për lirim nga pagimi i shpenzimeve procedurale (sipas nenit 7 te Udhëzimit Administrativ nga K.GJ. 2008/02 dhe neni 468.1 te Ligji Nr. 03/L-006)

Objekt kontesti : Kompensimi dëmit

Vlera e kontestit : 415400 €

1.) Paditësi së bashku me 8 anëtarët është detyruar ta braktisë shtëpinë si rezultat i presionit të forcave serbe .

2.) Provë :

- Kërkesa nr.580- 137 e datës 04.02.2009

- Deklarata për bashkësinë familjare sipas numrit rendor 035/477 e datës 30.12.2008

2.) Paditësi së bashku me naëtarët e familjës është detyruar ta braktisë disa her shtëpinë për tju ikur forcave serbe ,me datën 01 prill te vitit 1998 ka shkuar ne Shipol te Mitrovicës ne shtëpi te Ragip Zyhranit ku ka qendruar deri me datën 01.12.1998, nga aty është ç’vendosur ne Zhabar të Ulët të Mitrovicës ku ka qendruar plot dy vite deri me datën 01.12.2000,meqe nuk ka pas ku te kthehet ne fshat meqe shtëpitë ishin shendrruar ne gremadha,nga ajo datë nje donator i huaj “Adra” thekson se e ka strehuar tek Bedri Dervari ne Zhabar nga 1 janari i vitit 2001 deri me datën 1 janar 2003,ndërsa ne shtëpi kthehet ne muajin shtator te vitit 2003. Paditësit i është djegur shtëpia ne sipërfaqe prej 75 m² , te djegur dhe shkatërruar, duke përfshirë teknikën e bardhe dhe mobilerinë e dhomave te gjumit, pastaj i është djegur shtalla e bagtisë, hamari i ri i drithit dhe qarraniku (objekt për bylmet).

Provë : - Certifikata mbi te drejtat e pronës së paluajtshme UL-72015018-00002 e datës 29.12.2008

- Vërtetimi i Drejtorisë për Urbanizëm nr.325-126 i datës 29.12.2008

3.) Viktimës nga forcat ushtarake policore serbe të udhëhequra direkt prej qeverisë se Serbisë e cila ka kryer veprime gjenocidiale , krime kundër njerëzimit, i është shkatërruar pasuria , është detyruar ta braktis vendbanimin se bashku me fëmijët ne kohë zgjatje prej 4 vjetesh e një muaj .

Me datën 13.07.1990 si pasojë e veprimit politik është larguar nga vendi i punës polic ne Mitrovicë, ndërsa ne te njejtin vend pune rikthehet me datën 24.07.2000 kur edhe fillon te punoi ne SHPK. Te qenunit ne punë dhe lkargimin nga puna mund ta deshmojn koleget e punës ne cilsinë e deshmitarëve: 1. Bedri Haliti nga fshati Vajnik-Skenderaj dhe

2. Agim Idrizi nga fshati Kotorr-Skenderaj

Dëgjimi i paditësit dhe deshmitarve te propozuar si dhe provave te tjera te cilat paditësi do ti prezantoi ne seancat e shqyrtimit kryesor dhe ne rast nevojë te caktohet edhe eksperti përkatës

4.) Të drejtën për kompensim padisi e bazon në nenin 185 te LMD (G. Z. e RSFJ , Nr. 29 /78) në lidhje me nenin 180.1 te te njëjtit Ligj , me te cilin është paraparë që për demin e shkaktuar ndaj pasurisë te personave fizik si rezultat i dhunës dhe terrorit , përgjegjëse është „ Bashkia shoqërore politike ” e në këtë rast e paditura ka qen e obliguar te pengoj aktet e vrasjes , dhunës , terrorit , dëmtimit , asgjësimit dhe vjedhjes se pasurisë se paditësit .

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e te Drejtave dhe Lirive te Njeriut (neni 1 Protokolli nr. 1 , neni 2 dhe protokolli nr. 6 , neni 3 , neni 5 (5) , neni 10 dhe neni 14) .

Paditësi propozon qe kjo Gjykatë të caktoj shqyrtimin kryesor te çështjes , t'i shfrytëzoj informatat e duhura nga mjetet provuese të propozuara dhe

1.) pastaj të bjen këtë :

AKTGJYKIM

I. Aprovohet kerkes padija e paditësit Fazli Barani nga fshati Klinë e Epërme me vendbanim në Klinë të Epërme, 41000 Skenderaj Republika e Kosovës, në tersi si e bazuar .

II. Obligohet e paditura Qeveria e Serbisë si pasardhëse juridike e Qeverisë se me parshme qe ne emër te te njëjtës te kompensoj demin material dhe jo material paditësit Fazli Barani me vendbanim në Klinë të Epërme,- 41000 Skenderajt Republika e Kosovës, duke ja paguar;

- shumen prej 230 400 € për dhembjen shpirtërore dhe te munduarit , ndjekjes nga shtëpia , banimi ne qiell te hapur dhe shtëpi te huaja plot 4 vite e një muaj
- shumen prej 50 000 € për shkak te pamundësuarit e kremtimit te festave fetare ne shtëpi, vizitën dhe nderimin e varrezave , humbjes se kontaktit me farefis dhe te afërmit
- shumen prej 75 000 € për shtëpinë e djegur dhe te shkatrruar tersisht.
- Shumën prej 50 000 € ne emër te pagës për 10 vite sa ka qen i larguar nga puna si pasoj e vendimit politik
- shumen prej 10 000 € për; shtallën, hamarin dhe qarranikun(objektin për bylmet) e djegur.
- shumen prej € për pamundësimin e shfrytëzimit te tokës bujqesore ne siprfaqe prej 1 hektar e gjysum për pes vite.

te gjitha këto shuma me kamatë ligjore qe nga dita e ngritjes se padisë e deri ne ditën e pagesës definitive të gjitha këto në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se aktgjykimit , nen kërcënim te përmbarimit te dhunshëm .

Pala e paditur te paguaj shpenzimet procedurale te kësaj çështje juridike në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se aktgjykimit, nen kërcënim te përmbarimit te dhunshëm .

1.) të bihet :

AKTVENDIM

Mbi miratimin e propozimit të paditëses në ter çështjen juridike mbi lirimin nga pagimi i taksave dhe shpenzimeve tjera procedurale duke marr parasysh gjendjen e vështir ekonomike të paditëses në kuptim me nenin të Udhëzimit Administrativ nga K.GJ. 2008/02 dhe neni 468.1 të Ligji Nr. 03/L-006 .
Skenderaj , me dt. 03.05.2010

Paditësi

Fazli Barani



Shtojcë :

1. Kërkesa për kompensimin e dëmeve të luftës , nr.580- 137 e datës 04.02.2009
2. Deklarata për bashkësinë familjare sipas numrit rendor 035/ 477 e datës 30.12.2008
3. Certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme UL- 72015018-00002 e datës 29.12.2008
4. Vërteimi nga Drejtoria e Urbanizmit nr. 325- 126 i datës 29.12.2008
5. 4 kopje të padisë